



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.55/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Afijete Sada-Gllogjani dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor, Bajram Rexhahmetaj duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje(VV) dhe të organizatës Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Prizren, për shkak të vendosjes së panos në objektin publik për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 26.09.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohen si të bazuara ankesat e Lëvizja Vetëvendosje(VV) me seli në Prishtinë,dhe organizatës Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), kështu që subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Prizren, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 900.00(nëntëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i ka pranuar dy ankesa ZL.Anr.55/2017 nga Lëvizja Vetëvendosje(VV) me datën 24.09.2017, dhe ankesa ZL.Anr.61/2017 nga Insituti Demokratik i Kosovës (KDI), me datë 25.09.2017, me të cilën pretendojnë se në rrugën “Willam Walker” në Prizren, ishte vendosur pano i kandidatit për Anëtar të Kuvendit Komunal në Prizren, Xhavit Ukaj nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të ngjitur në objektin publik përkatësisht në murin e Kinemasë së qytetit të Prizrenit. Parashtruesit e ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Paneli i PZAP -it, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartcekura dhe i trajton si një ankesë evidentuar me ZL.Anr.55/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për të dy ankesat i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës .

Në përgjigje në ankesën ZL.Anr.55/2017 dhe ZL.Anr.61/2017, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të datës 25.09.2017, ka pranuar shkeljet e pretenduara në ankesa duke arsyetuar se paraqiten mungesa absolute për vendet e dedikuara për reklamime politike dhe posterit i vendosur nuk mund të konsiderohet si shkelje sipas dispozitave të LPZ-së, meqenëse se vendosja e tyre nuk cenon objektin dhe as funksionalitetin e tij, dhe se pas marrjes së ankesave nga ana e PZAP-së, ka ndërmarrur masat përmirësuese, për evitimin e shkeljes

sipas ankesave. Përgjigjes së ankesave si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkëngjitur fotografi nga vendi ku janë larguar posterat.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografit e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se pano i kandidatit për Anëtarë të Kuvendit Komunal në Prizren, Xhavit Ukaj nga radhët e subjektit politik LDK, janë vendosur në murin e Kinemasë së qytetit të Prizrenit, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik LDK, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që pano i kandidatit për Anëtarë të Kuvendit Komunal në Prizren, Xhavit Ukaj nga radhët e subjektit politik LDK, janë vendosur në objektin publik. Të cilën shkelje e ka pranuar edhe vetë subjekti politik LDK, në përgjigjen në ankesë të datës 26.09.2017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:


- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër këtij fakti pano i kandidatit nga subjekti politik i LDK-së, është vendosur në objektin publike. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që subjektit politik në fjalë, iu dha mundësia për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë hequr pano nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.Anr. 55/2017 më datën 26.09.2017.



**Kryesuesi i Panelit
Zyhdi Haziri**

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.